

Statuti i Shoqatës

Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë - Tiranë

Në mbështetje të Ligjit nr. 7580, datë 29.07.1994, nenet 39-53, Ligjit Nr. 8781 datë 03.05.2001 dhe Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001, hartohet ky Statut i shoqatës "Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë" – Tiranë. Kjo shoqatë është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj pa qëllim fitimi, joqeveritare.

Neni 1

Emërtimi i Shoqatës

Emërtimi i Shoqatës do të jetë "Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë" – Tiranë.

Neni 2

Qëllimi i veprimtarisë së Shoqatës

Qëllimi i veprimtarisë së Shoqatës do të jetë:

Ruajtja, evidentimi, zhvillimi e përhapja e vlerave materiale e kulturore të objekteve të koleksionimit, si pulla postare, numismatika, kartolina, medalje, monedha, libri i vjetër dhe veprat e artit. Nëpërmjet tyre të përhapim kulturën e koleksionimit, të katalogojë dhe të botojë artikuj studimorë në revistën periodike 6 mujore "Koleksionisti".

Organizimi i veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare me ekspozita të filatelistë etj. në Tiranë dhe qytete të tjerë të Shqipërisë. T'u përgjigjet denjësisht ftesave të FEPA (Federata e Shoqatave Filatelike Europiane) dhe FIP (Federata Ndërkombëtare Filatike), të mbajë lidhje dhe t'i forcojë ato me koleksionistët e Republikës së Kosovës duke organizuar takime, konsulta, shkëmbim përvoja dhe ekspozita, të mbajë lidhje me Postën Shqiptare nëpërmjet përfaqësuesit të saj në komisionin e pullës postare, të informojë dhe të kërkojë ndihmë nga Ministria e Kulturës për çështje që lidhen me hapësirat e ekspozimit që zotërojnë institucionet në varësi të saj në rastet kur Shoqata e koleksionistëve të organizojë ekspozita kombëtare.


Neni 3

"Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë" – Tiranë ka për detyrë të zbulojë dhe hulumtojë pasionin e anëtarëve që merren me koleksionimin e objekteve të llojeve të ndryshme, të pullave, të kartëmonedhave, monedhave, medaljeve, kartolinave, fotografive, objekteve antike, veprave të artit etj.

Neni 4

"Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë" – Tiranë nuk është shoqatë politike por është një organizëm vullnetar i pasionistëve që punon dhe lufton për progresin e gjithanshëm të anëtarëve të saj.

Neni 5



“Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë” – Tiranë do të njohë vlerat reale të çdo individi dhe grupi shoqëror dhe sidomos të anëtarëve të saj në territorin e Shqipërisë apo jashtë saj dhe do t’i publikojë në aktivitete të ndryshme që do të organizojë.

Neni 6

“Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë” – Tiranë me mundësitë që do të ketë dhe do t’i krijohen brenda Ligjeve dhe Rregullave përkatëse, do të ndihmojë anëtarë të veçantë të Shoqatës që do të kenë nevojë për ndihma të ndryshme.

Neni 7

“Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë” – Tiranë do të ndihmojë për të krijuar marrëdhënie të drejta shoqërore, miqësore, me anëtarët e shoqatës duke respektuar kodin e sjelljes.

Neni 8

Qendra dhe territori i veprimtarisë

Selia e Shoqatës do të jetë në Rrugën “ Ibrahim Rugova “ Pall. Qeveritar “,Ap.2, Tiranë - 1057.

Veprimtaria e saj do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë pavarësisht se qendrën do ta ketë në Tiranë, si dhe në çdo vend tjetër brenda dhe jashtë trojeve shqiptare ku anëtarët e saj e shohin të arsyeshme.

Neni 9

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqatës “Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë” – Tiranë është për një periudhë kohe të pacaktuar.




Neni 10

Kushtet e pranimit dhe largimit të anëtarëve

Në shoqatë kanë të drejtë të anëtarësohen të gjithë personat fizikë apo juridikë shqiptarë, apo të huaj që koleksionojnë objekte shqiptare filatelike, numizmatike dhe te tjera, pa dallim bindje politike, fetare, arsimit, seksi, banorë të qytetit apo të fshatit, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që pranojnë dhe zbatojnë kërkesat e Statutit dhe të Ligjit. E drejta për dhënie dorëheqje i garantohet çdo anëtar të shoqatës por me kusht që ai të paraqesë një kërkesë së paku një muaj përpara largimit.

Neni 11

E drejta e anëtarësisë në Shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me dëshmi trashëgimie.



Anëtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose janë përjashtuar nga Shoqata nuk kanë të drejtë në kapitalin apo në pasurinë themelore të Shoqatës të krijuar gjatë formimit, aktivitetit dhe funksionimit të saj.

Neni 12

Të drejta dhe detyrat e anëtarit:

Çdo anëtar ka të drejtë të shfaqë mendimin e tij hapur, të diskutojë në mbledhje, të kërkojë llogari për harxhimin e fondeve.

Të zgjedhë organet drejtuese të Shoqatës.

Të zgjidhet në Organet drejtuese të Shoqatës, me anëtarësim jo më pak se tre vjet.

Të përfitojë nga çdo shërbim të siguruar prej Shoqatës.

Të shqyrtojë llogaritë vjetore të Shoqatës nëpërmjet komisionit që ngre Shoqata.

Të marrë pjesë në veprimtarinë e Shoqatës.

Të respektojë rregullat e parashikuara në Statut, rregullat e brendëshme që mund të aprovojë mbledhja e përgjithshme e anëtarëve dhe vendimet e Shoqatës.

Të gjithë anëtarët duhet të paguajnë një kuotë vjetore vlera e së cilës përcaktohet në Nenin 16.

Kuota e anëtarësisë duhet të paguhet deri më 30 Prill të vitit kalendarik. Në vitin zgjedhor nëse Mbledhja e Përgjithshme zhvillohet para datës 30 prill atëherë kuota duhet paguar para zhvillimit të Mbledhjes së Përgjithshme. Në rast të kundërt anëtari nuk ka të drejtë vote në Mbledhjen e Përgjithshme.

Çdo anëtar që nuk paguan kuotën për një periudhë prej dy vitesh kalendarikë, anëtarësinë do ta ketë të pezulluar. Në se mospagimi është me i gjatë se dy vjet, anëtarësia do të jetë e anuluar.

Anëtari i pezulluar nuk ka të drejtë vote, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ekspozita rajonale, kombëtare apo ndërkombëtare si dhe të marrë falas Revistën Koleksionisti.

Riaktivizimi i anëtarësisë do të pranohet nëse do të paguhet të gjitha detyrimet e prapambetura.

Neni 13


Organet drejtuese, mënyra e formimit dhe kompetencat e tyre

Organi më i lartë i Shoqatës është Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve të Shoqatës.

Kuorumi i nevojshëm që Mbledhja e përgjithshme të marrë vendim duhet të jetë prezenca fizikisht dhe me përfaqësim të më shumë se gjysmës së anëtarëve me të drejtë vote në apelin e parë. Çdo anëtar mund të përfaqësojë vetëm një anëtar tjetër.

Nëse nuk plotësohet kuorumi, Mbledhja e përgjithshme do të thirret edhe një herë nga Këshilli Drejtues 30 minuta pas apelit të parë. Kjo mbledhje e Përgjithshme e përsëritur e ka kuorumin me çdo numër anëtarësh të pranishëm.

Në rast barazimi votimi do të përsëritet.



Nëse një anëtar kërkon votë të fshehtë atëhere bëhet votim i fshehtë për çështjen apo mocionin në shqyrtim.

Votat me shkrim, të anëtarëve jo të pranishëm apo të paraqitura me përfaqësi nuk pranohen në Mbledhje të Përgjithshme.

Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e anëtarëve.

Miraton programin vjetor të aktiviteteve që do të realizojë Shoqata për realizimin e objektivave të parashikuar në këtë statut.

Mbledhja e përgjithshme zgjedh ose shkarkon Kryetarin, Këshillin Drejtues me votim të fshehtë.

Të gjithë anëtarët e Shoqatës me të drejtë vote, kanë të drejtë vote të barabartë në Mbledhjen e Përgjithshme.

Për përjashtimin e një anëtari dhe për shpërndarjen e Shoqatës duhet të jenë të pranishëm, personalisht ose te përfaqësuar, të paktën $\frac{3}{4}$ e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 14

Këshilli Drejtues i Shoqatës zgjidhet çdo 4 vjet me votim të fshehtë nga mbledhja e përgjithshme.

Këshilli drejtues i Shoqatës zgjedh Kryetarin, Nënkryetarin, sekretarin dhe një përgjegjës për financën.


Kryetari i Shoqatës zgjidhet për një periudhë kohë 4-vjeçare me të drejtë ripërtëritje por jo më shumë se dy mandate. Mbledhjet e Këshillit janë të rregullta kur janë ftuar të gjithë anëtarët dhe marrin pjesë në të gjysma e tyre.

Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të pranishme në mbledhje.

Në rast se votat janë të barabarta vota e Kryetarit të Shoqatës konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve.

Këshilli drejtues i Shoqatës ka këto kompetenca:

- Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe ja paraqet për miratim Mbledhjes së përgjithshme.
- Aprovon raportin vjetor të realizimit të detyrave të Shoqatës.
- Cakton mënyrën e realizimit të të ardhurave të Shoqatës.
- Vendos për ndryshimet që duhen bërë në rregullimet e Shoqatës.
- Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga Organe dhe Organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi dhe ndihme të ndërsjellë.
- Diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhjes dhe merr vendime rreth tij.



- Punësimin e personave në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- Këshilli Drejtues është Organi më i lartë i Shoqatës. Numri i anëtarëve që përbëjnë Këshillin Drejtues është 7-11 dhe vendoset në Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës.
- Në çdo Rreth të Republikës së Shqipërisë me të paktën 5 anëtarë krijohet një Degë në përbërje të Shoqatës. Kryetarët e Degëve në Rrethe kooptohen si anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqatës së Koleksionistëve të Shqipërisë.
- Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë vote.
- Për drejtimin e Këshillit Drejtues zgjidhet një Kryetar dhe një zëvendës të cilët kanë të drejtë vote të barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të Shoqatës.
- Anëtarët e Këshillit Drejtues shkarkohen nga posti i tyre kur ata mungojnë pa arsye në mbledhjet e Kryesisë tre herë rradhazi ose kur humbasin të drejtën e anëtarit të shoqatës.
- Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet në Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës me propozim të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues administron punën e Shoqatës. Ai përgjigjet për:

- Zgjedhjen e Nënkrëtarit dhe Sekretarit.
- Zbatimin e rekomandimeve të planit të Shoqatës, Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë - Tiranë sipas planit të investimeve të të ardhurave të grumbulluara nga ndihmat e ndryshme, donatorë të tjerë dhe burime të tjera të ligjshme.
- Formulimin e çdo rregulli të brëndshëm që mund të gjykohej i nevojshëm për administrimin e Shoqatës dhe drejtimin e anëtarëve që do t'i parashtrohen Mbledhjes së Përgjithshme.
- Përgatitjen e programit vjetor të veprimtarisë së Shoqatës që do t'i parashtrohen Mbledhjes së Përgjithshme.
- Përpunimin me hollësi mbi baza vjetore të parashikimit të shpenzimeve dhe llogarive vjetore që do t'i parashtrohen mbledhjes së përgjithshme.
- librat e llogarive dhe rregjistrave të marrëdhënieve të Shoqatës me të tretët.
- Administrimin e fondit të Shoqatës.
- Organizimin e kontrolleve dhe inspektimeve mbi aktivitetin e Shoqatës.
- Zbatimin e vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës.
- Propozon për pranimin apo përjashtimin e anëtarëve.
- Këshilli Drejtues mbledhet rregullisht në fund të çdo muaji. Kur paraqitet nevoja ose sipas kërkesës së të paktën tre anëtarëve të Këshillit Drejtues mund të thirret mbledhje e veçantë nga kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendësi. Njoftimi për mbledhje jepet të paktën 5 ditë para ditës së caktuar për mbledhje. Njoftimi tregon ditën, kohën, vendin dhe qëllimin e mbledhjes.
- Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose në mungesë të tij nga zëvendësi.
- Sekretari ose një anëtar i caktuar mban protokollin për diskutimet dhe vendimet.
- Protokollet mbahen në librin që ruhet në administratën e Shoqatës.
- Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të paktën më shumë se gjysma e anëtarëve duke përfshirë Kryetarin ose Zëvendës Kryetarin. Vendimet merren me shumicë votash. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote.

Neni 15

Kryetari i Shoqatës zgjidhet nga Këshilli Drejtues dhe ka këto kompetenca:

- Drejton veprimtarinë e Shoqatës në bazë të Statutit.

- Administrojnë fondet sipas mënyrës së caktuar nga Këshilli Drejtues. Shpenzimet financiare urdhërohen nga Kryetari i Shoqatës në masën 25% të buxhetit dhe mbi këtë masë nga Këshilli Drejtues i Shoqatës.
- Hyn në marrëdhënie me Shoqata të tjera.
- Përgatit dhe thërret Mbledhjen e Këshillit Drejtues të Shoqatës.
- Kujdeset për interesat e Shoqatës, i mbrojnë ato si dhe përfaqëson Shoqatën në marrëdhënie me të tretët.
- Përfaqëson Shoqatën para ligjit, shtetit, medias, opinionit publik, Organeve dhe Institucioneve të tjera të njohura me ligj, në marrëdhënie me palët e treta e në procedurat juridike dhe nënshkrimin e çdo kontrate në të cilën Shoqata merr pjesë, si dhe çdo veprim ose dokument të Shoqatës sipas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues.
- Siguron zbatimin e të gjitha vendimeve të Këshillit Drejtues.
- Siguron rregjistrimin e Statutit dhe çdo ndryshim në Gjykatën kompetente.
- Mbikqyr rregullin në marrëdhënie me librat dhe dokumentet e Shoqatës.
- Ushtron kompetencat dhe zbaton detyrat që Këshilli Drejtues mund t'i ngarkojë atij nga një periudhë në një tjetër.

Neni 16 **Mjetet financiare të Shoqatës**

Shoqata hap llogarinë e vet pranë bankave të nivelit të dytë.

Të ardhurat e Shoqatës do të sigurohen si të vendoset pas mbledhjes së parë të përgjithshme të anëtarëve. Çdo anëtar i Shoqatës do të paguajë kuotizacionin e tij çdo vit në shumën 2000 lekë, të huajt 25 euro.

Gjithashtu burim financiar Shoqata do të ketë nga ndihma, nga donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit nga persona juridikë dhe fizikë, dhurata të ndryshme në lekë, valutë, letra me vlerë, sende të luajtshme e të paluajtshme dhe çdo burim tjetër i lejuar nga ligji.


Buxheti i Shoqatës do të konsistojë dhe nga programet e financuara nga Organizata ndërkombëtare, fondacionet e huaja dhe nacionale, bordet kombëtare dhe ndërkombëtare, rajonale e lokale.

Në këto raste do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve dhe do të përpilohet dokumentacioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17 **Përdorimi i të ardhurave**

Shoqata bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilin është krijuar si dhe për drejtimin dhe mirëmbajtjen e zyrave, orendive dhe mjeteve të domosdoshme për funksionimin e shoqatës.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e shoqatës midis anëtarëve të saj, përveç shpërblimeve dhe ndihmave të ndryshme që mund t'ju jepen anëtarëve të veçantë për merita ose punë të



kryera në të mirë të Shoqatës. Kryetari i Shoqatës paguhet sipas buxhetit të Shoqatës me pagë të caktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Shoqatës.

Këshilli Drejtues do të administrojë financat e Shoqatës. Anëtari i këshillit Drejtues përgjegjës për këtë detyrë është financieri. Financieri mund të ricaktohet.

Nuk ka limit se sa herë një anëtar i Këshillit Drejtues mund të ricaktohet që të shërbejë si financier.

Financieri do të mbajë të gjitha fondet dhe do të mbledhë dhe paguajë në emër të Shoqatës. Ai do të mbajë llogarinë e të gjitha transaksioneve financiare.

Çdo veprim financiar do të kryhet vetëm pas konfirmimit të financerit. Çdo shpenzim që kalon limitin e aprovuar nga Këshilli Drejtues do të kërkojë nënshkrimin e Kryetarit përveç asaj të financerit.

Financieri do të mbyllë llogaritë deri më 31 dhjetor të çdo viti dhe do t'ja paraqesë Këshillit drejtues deri më 31 Mars të vitit pasues pas auditimit të brendshëm nga audituesi. Brenda këtij afati hartohet Bilanci financiar i cili dorëzohet në Zyrën e Tatimeve sipas Ligjit.

Neni 18

Mbajtja e librave dhe rregjistrave të nevojshëm

Mban rregjistrimin për të drejtën e votës për çdo anëtar, rregjistër me të dhëna të plota për çdo anëtar dhe shtesat e anëtarëve të rinj, rregjistër inventari për të gjitha pajisjet, makineritë dhe veglat që zotëron Shoqata dhe që janë gjëndje, ose do të blihen apo dhurohen nga Shoqata të tjera apo donatorë të ndryshëm.

Neni 19

Shoqata do të ketë vulën e saj me mbishkrimin: "Shoqata e Koleksionistëve të Shqipërisë" – Tiranë, të cilën e përdor Kryetari apo i autorizuari prej tij.

Neni 20

Mënyra e ndryshimit të Statutit

Të gjitha ndryshimet e Statutit bëhen vetëm me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme ku në të të marrin pjesë fizikisht dhe me përfaqësi jo më pak se 50 % (pesedhjetë përqind) +1 të anëtarëve me të drejtë vote. Këto ndryshime do të kërkojnë vota pro të më shumë se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të pranishëm dhe me përfaqësi, me të drejtë vote.


Ndryshimet në Statut do të bëhen në rast se nuk përmbushet ndonjë nga objektivat e parashikuara në Statut.

Neni 21

Mënyra e shpërndarjes së Shoqatës

Shoqata shpërndahet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të thirrur nga Këshilli Drejtues.

Shoqata shpërndahet kur numri i anëtarëve është nën pesë veta, kur qëllimi i saj është



përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet ose ka humbur aftësitë drejtuese.

Me vendim të gjykatës kur Shoqata largohet nga qëllimi i saktësuar në statut ose kryen veprimtari të kundërligjshme.

Në rast shpërndarjeje të Shoqatës ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. Likuidatori ka autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e Shoqatës që nga dita e emërimit të tij deri në përfundimin e procesit të likuidimit.

Likuidatori caktohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës ku dhe i cakton të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 22

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Shoqatës në Gjykatën e Rrethit Gjygjësor Tiranë, ku në këtë ditë Shoqata njihet dhe si person juridik.

Neni 23

Për çka është shprehur në Statut i referohet ligjeve në fuqi si dhe dispozitave të rregullores së Shoqatës “Shoqata e koleksionistëve të Shqipërisë” - Tiranë si dhe dispozitave ligjore për Organizatat jo fitim prurëse në Republikën e Shqipërisë.

Çështjet që nuk mbulohen nga Statuti do të zgjidhen nga Këshilli Drejtues dhe do të ratifikohen nga Mbledhja e Përgjithëshme pasuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rast të mospërputhjeve të interpretimit të këtij Statuti Këshilli Drejtues do të vendosë dhe veprë sipas paragrafit të mësipërm.

KRYETARI I SHOQATËS

JULIAN DEMETI
